Kosova

Zyra për monitorim dhe luftim të trafikimit me njerëz

Raporti i vitit 2014 mbi trafikimin e personave

Niveli 2

Kosova është burim dhe destinacion për gra, fëmijë dhe disa burra që i nënshtrohen trafikimit për seks dhe punë të detyruar. Shumica e viktimave të trafikimit për seks në Kosovë janë femra, ndonëse viteve të mëparshme femrat nga Moldavia, Sllovakia, Shqipëria, Serbia, Turqia dhe Polonia gjithashtu janë përballur me prostitucion të detyruar nga grupe kriminale në Kosovë. Fëmijët nga Kosova dhe vendet fqinje, përfshirë Shqipërinë, i nënshtroheshin lypjes së detyruar brenda vendit. Një numër i madh i vajzave të moshës 14-17 vjeçare ishin viktima të trafikimit për seks. Femrat dhe vajzat i nënshtrohen trafikimit për seks në shtëpi dhe banesa private, klube të natës dhe lokale të masazhit. Trafikantët i mashtronin viktimat duke u premtuar punësim si valltare dhe këngëtare në restorante dhe, në vend të kësaj, i detyronin në trafikim për seks në banesa private. Trafikantët i detyrojnë shtetasit kosovarë të merreshin me prostitucion dhe punë të detyruar në mbarë Evropën. Thuhej që trafikantët e shfrytëzonin regjimin pa viza për t'i prurë viktimat në Evropë.

Qeveria e Kosovës nuk vepron tërësisht në pajtim me standardet minimale për eliminimin e trafikimit; megjithatë, ajo është duke bërë përpjekje të mëdha për ta bërë këtë. Qeveria hapi një strehimore të re për viktima, duke i akomoduar viktimat meshkuj për herë të parë, dhe e rriti financimin për mbrojtjen e viktimave. Një ligj i ri për mbrojtje të viktimave përcaktonte, ndër risi të tjera, lejen e qëndrimit për viktima të huaja të trafikimit. Gjykatat shënuan përparim në uljen e numrit të rasteve të prapambetura. Megjithatë, qeveria u përpoq t'i mbante përgjegjës autorët e trafikimit. Qeveri dënoi më pak kriminelë dhe u shqiptoi dënime më të buta trafikantëve të dënuar. Disa dispozita të ligjit të ri për mbrojtje nuk u zbatuan ende gjatë kësaj periudhe të raportimit, përfshirë fondin për kompensim të viktimave dhe lejen e re për qëndrim.

Rekomandimet për Kosovën:

T'i ndjekë penalisht krimet dhe t'i dënojë e ndëshkojë autorët e trafikimit; t'i hetojë dhe forcojë përpjekjet për t'i ndjekur, gjykuar dhe dënuar zyrtarët e përfshirë në trafikim; t'u ofrojë gjyqtarëve, prokurorëve dhe organeve për zbatim të ligjit trajnime të avancuara kundër trafikimit; t'i shtojë përpjekjet për t'i identifikuar dhe për t'u ndihmuar fëmijëve që trafikohen për lypje; të sigurojë që dispozitat e reja për mbrojtje, të përcaktuara në ligjin e shtatorit të vitit 2013, zbatohen plotësisht; ta zbatojë kontrollin për trafikim ndër migrantë që janë në rrezik; të ofrojë leje të reja të përkohshme qëndrimi për viktima të huaja të trafikimit dhe dëshmitarë në raste të trafikimit; të sigurojë që viktimat e trafikimit kanë liri për të ardhur dhe shkuar në të gjitha strehimoret; ta themelojë dhe financojë një fond për kompensim të viktimave, siç parashihet me ligjin e Kosovës; dhe të vazhdojë ta përmirësojë transparencën përmes raportimit të rregullt.

Ndjekja

Qeveria e Kosovës i mbështeti përpjekjet për zbatim të ligjit kundër trafikimit gjatë kësaj periudhe të raportimit; numri i ndjekjeve penale u shtua, por më pak autorë të trafikimit u

dënuan dhe dënimet ishin tejet të buta. Neni 171 i Kodit Penal të Kosovës i ndalon të gjitha format e trafikimit për seks dhe punë dhe përcakton dënime prej 5 deri në 12 vjet burg dhe gjoba. Këto dënime janë mjaft të rrepta dhe në përputhje me dënimet e përcaktuara për krime të tjera të rënda, si dhunimi. Policia kishte një forcë të caktuar kundër trafikimit, të përbërë nga 55 policë, që i hetonte rastet e trafikimit dhe krime të tjera të lidhura. Autoritetet filluan 91 hetime të reja kundër trafikimit gjatë kësaj periudhe të raportimit, krahasuar me 104 hetime në vitin 2012. Nuk pati hetime për punë të detyruar. Gjykatat filluan ndjekjet penale në 60 raste të reja në vitin 2013, një rritje nga 31 raste në vitin 2012. Gjykatat i dënuan 25 autorë të trafikimit, përfshirë një zyrtar publik, në vitin 2013; krahasuar me 41 në vitin 2012. Gjykatat i liruan tre të pandehur, krahasuar me nëntë në vitin 2012, dhe 90 ndjekje penale mbetën në vazhdim e sipër në fund të kësaj periudhe të raportimit. Dënimet silleshin prej katër muaj deri në gjashtë vjet burg dhe me gjoba. Një autorë i trafikimit u dënua me kusht dhe me gjobë. Prokurorët nganjëherë i hidhnin apo i ulnin akuzat për trafikim në akuza më të vogla, për jo-trafikim dhe dënimet e të dënuarve ishim shumë më të ulëta sesa kufijtë e përcaktuar me ligjin në fuqi. Nuk pati ndjekje penale apo dënime për trafikim për punë gjatë kësaj periudhe të raportimit. Gjykatat vazhduan ta ulnin numrin e rasteve të prapambetura. Korrupsioni mbeti problem brenda forcës policore. Autoritetet kosovare gjoja arrestuan dhe suspenduan një zyrtar për përfshirje të supozuar në trafikim të personave; hetimi është në vazhdim e sipër. Prokurorët vazhduan rastet kundër dy zyrtarëve të Ministrisë së Punës dhe dy policë u arrestuan për trafikim në vitin 2012. Një polic, i cili e nënshtroi një kolege police në trafikim për seks, u lirua. Qeveria i trajnoi zyrtarët për zbatim të ligjit në identifikimin e viktimave të trafikimit, në kodin penal dhe në procedurat për hetimin e rasteve të trafikimit dhe për ndihmë dhe mbështetje viktimave gjatë hetimeve. Akademia policore mbajti 44 trajnime për forcën speciale të policisë kundër trafikimit. Qeveria shkëmbeu informata për trafikim me vendet fqinje në 18 raste të trafikimit, por nuk u angazhua në asnjë hetim të përbashkët.

Mbrojtja

Qeveria i përmirësoi përpjekjet për t'i mbrojtur viktimat e trafikimit, duke hapur një objekt të ri për të gjitha viktimat e trafikimit, përfshirë meshkujt; duke shtuar financimin për ndihmë për viktima; dhe duke përcaktuar një leje qëndrimi për viktima të trafikimit. Në shtator të vitit 2013, Qeveria e Kosovës miratoi një ligj të ri, "Ligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit", i cili përcaktonte masa të reja mbrojtëse. Policia identifikoi 51 viktima të trafikimit në vitin 2013, krahasuar me 54 në vitin 2012, katër ishin meshkuj të rritur dhe 12 ishin fëmijë, krahasuar me 23 viktima fëmijë dhe asnjë mashkull të rritur në vitin 2013. Autoritetet zyrtarisht nuk identifikuan asnjë viktimë të trafikuar për punë, përkundër faktit që policia kishte identifikuar 66 fëmijë lypsarë. Qeveria hapi një strehimore 24-orëshe të sigurisë së lartë, me të cilën e zëvendësoi strehimoren e vjetër. Kjo strehimore ofronte hapësira të veçanta për viktima të rrezikut të mesëm dhe të lartë sipas gjinisë. Kjo strehimore u ofronte mbështetje 40 viktimave të identifikuara; 11 viktima të tjera e refuzuan këtë ndihmë. Viktimave të rritura nuk u lejohej të dilnin nga strehimorja të pashoqëruara. Viktimat vendoseshin në strehimore të sigurisë së lartë gjersa policia ta kryente vlerësimin e rrezikut për të përcaktuar nëse kishte kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj viktimave. Nëse konstatohej që viktimat ishin në rrezik të ulët, ato vendoseshin në strehimore të OJQ-ve. Në vitin 2013, Qeveria filloi monitorimin dhe lëshimin e lejeve për punëtorë socialë dhe strehimore. Qeveria ndau një buxhet prej rreth 110.000 dollarëve për strehimoren e rrezikut të lartë të drejtuar nga qeveria, krahasuar me rreth 84.600 dollarë në vitin 2012. Gjashtë strehimore të OJQ-ve, përfshirë strehimoret që i strehojnë

viktimat e dhunës në familje, dhe një qendër për ndihmë viktimave, pranuan rreth 239.000 dollarë, krahasuar me rreth 198.000 dollarë në vitin 2012.

Ligji i ri për trafikim rregullon trajtimin e viktimave gjatë hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve; p.sh., duke kufizuar numrin sa herë fëmija mund të intervistohet, duke mbrojtur identitetin e atyre viktimave, dhe duke siguruar që atyre u ofrohen shërbime sociale dhe psikologjike. Avokatët e viktimave ose punëtorët socialë ishin të pranishëm kur policia i intervistonte viktimat potenciale të trafikimit. Avokatët e viktimave u ndihmonin viktimave të trafikimit me këshilla ligjore dhe mbështetje për riintegrim. Punëtorët socialë ishin të pranishëm kur intervistoheshin viktimat potenciale fëmijë të trafikimit. Viktimat fëmijë të trafikimit vendoseshin në strehimore vetëm për fëmijë ose në kujdes afatgjatë. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, ndonëse ligji ishte ndryshuar për t'u ofruar status të qëndrimit viktimave të huaja dhe dëshmitarëve në raste të trafikimit, qeveria nuk pranoi asnjë kërkesë për status të qëndrimit. Ligji i ri gjithashtu kërkon që viktimave t'u caktohet një periudhë e reflektimit – një kohë në të cilën ato mund të rimëkëmben para se të vendosin nëse do të bashkëpunojnë me organet për zbatim të ligjit. Ndonëse ligji i ri kërkonte që qeveria ta miratonte ligjin për themelimin dhe financimin e një fondi për kompensim të viktimave, qeveria nuk e kishte miratuar ligjin e nevojshëm për themelimin e fondit për kompensim të viktimave deri në fund të periudhës së raportimit. Nuk pati raportime që qeveria i kishte ndëshkuar viktimat e trafikimit për akte të paligjshme të kryera si rezultat i drejtpërdrejtë i të qenët i trafikuar. Ligji i shtatorit të vitit 2013 përcaktoi një dispozitë të re me të cilën i lironte viktimat e trafikimit nga përgjegjësia për krime të kryera si rezultat i drejtpërdrejtë i të qenët i trafikuar.

Parandalimi

Qeveria i vazhdoi përpjekjet e shumta për ta parandaluar trafikimin e personave. Në vitin 2013, qeveria financoi sekretariatin kundër trafikimit pa ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë. Qeveria gjithashtu drejtoi një fushatë që synonte viktimat potenciale të trafikimit, përfshirë studentët, fëmijët dhe gratë, për ta ngritur vetëdijesimin për trafikim të njerëzve dhe identifikim të viktimave. Fushata prezantoi porosi në radio, TV dhe media të shkruara në gjuhën shqipe, serbe dhe rome dhe kishte një komponent edhe në mediet sociale. Policia kundër trafikimit mori pjesë në debate dhe tryeza të rrumbullakëta kundër trafikimit nëpër komuna, qendra të rinisë dhe universitete, dhe në orë mësimi në shkolla fillore e të mesme. Grupi koordinues kombëtar takohej një herë në muaj për t'i monitoruar aktivitetet kundër trafikimit dhe mbrojtjen dhe ndihmën për viktima të trafikimit. Ky grup përbëhet nga zyrtarë qeveritarë, organizata ndërkombëtare dhe OJQ. Në një përpjekje për ta shtuar transparencën, Policia e Kosovës publikoi një raport të plotë vjetor mbi përpjekjet e organeve për zbatimin e ligjit në luftën kundër trafikimit. Qeveria nuk demonstroi përpjekje për ta ulur kërkesën për akte të seksit komercial apo punë të detyruar.